



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:287064

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05280485

P.2021:294414

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Shpresa Hoxha, në çështjen penale kundër të pandehurit H.D, i akuzuar për shkak të veprës penale Keqpërdorim i besimit nga neni 330 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.1526/21 të datës 13.02.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më datë 29.01.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Fatos Ajvazi, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare Avokat Hebib Livoreka, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 02.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit: H.D me vendbanim në Rr.“...”, nr..., Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë ..., nga i ati H... dhe e ëma M... e gjinisë Sh..., me numër personal ..., i martuar, ka të kryer Fakultetin Ekonomik në UP, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës

Në bazë të nenit 362 paragrafi 1, nën paragrafi.1.1 të KPP-së.

REFUZOHET AKUZA

I. Prej muajit Mars-Maj të vitit 2021, në rrugën “Adem Jashari”, Hani Elezit, konkretisht në Njësinë e Subjektit Afarist “...”, Sh.P.K, Nr., me numër të biznesit ..., i pandehuri si person përgjegjës-Ushtrues Detyrës Menaxher, në Departamentin fresh dhe hixhienë, gjatë kujdesit të interesave dëmtuarës së lartcekur nuk i ka përmbushur detyrimet e tij dhe i ka shkaktuar dëm, në atë mënyrë që nuk i ka njoftuar furnitorët e mallit “...” dhe “... dhe menagjeret e tij me kohë-para skadimit të afatit të artikujve ushqimor në sektorin e produkteve të freskëta ushqimore dhe të njëjtin mall me afat skaduar e ka hedhur në kontejnerë të mbeturinave, me ç’ rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 746,94€.

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Keqpërdorim i besimit nga neni 330 paragrafi 1 të KPRK-së

II. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka ngritur aktakuzë PP/II.nr.1526/21 të datës 28.12.2021, e cila është plotësuar më datë 13.02.2023, kundër të pandehurit të lartë shënuar për shkak të veprës penale Keqpërdorim i besimit nga neni 330 paragrafi 1 të KPRK-së

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale sipas aktakuzës PP/II.nr.1526/21 të datës 28.12.2021, e cila është plotësuar më datë 13.02.2023, kundër të pandehurit H.D për shkak të veprës penale Keqpërdorim i besimit nga neni 330 paragrafi 1 të KPRK-së

Andaj meqenëse prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza dhe ndjekja penale pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor, gjykata duke u bazuar në nenin 362 paragrafi 1 nën paragrafi.1.1 të KPP-së, ka refuzuar aktakuzën e Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.1526/21 të datës

28.12.2021, e cila është plotësuar më datë 13.02.2023, kundër të pandehurit H.D për shkak të veprës penale Keqpërdorim i besimit nga neni 330 paragrafi 1 të KPRK-së

Andaj duke u bazuar në të lartcekura dhe në bazë të nenit 362 paragrafi 1 nën paragrafi.1.1 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.2021:294414, me datë 02.02.2024

Procesmbajtëse

Shpresa Hoxha

Gjyqtari

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:287064
Datë: 02.02.2024
Numri i dokumentit: 05280485